



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

PROJEKT RREGULLORE

PËR KUSHTET DHE KRITERET E PERSONIT JURIDIK
QË DO TË VEPROJË SI AGJENT I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT

Miraturar me Vendim Bordi _____

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë personat juridik që do të veprojnë si agjentë të fondit të pensionit privat, përcaktimin e rregullave për t'u regjistruar nga shoqëria administruese si edhe të kushteve për të ushtruar veprimtarinë si agjent i fondit të pensionit privat.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, i ndryshuar dhe të nenit 81, pika 4; të nenit 87, pika 7, të ligjit nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat".

Neni 3

Përkufizime

Në këtë rregullore:

1. "Institucion financiar" është:

- a) Banka apo dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë;
- b) Subjekti financiar jo bankë, i licencuar nga Banka e Shqipërisë;
- c) Shoqëria e sigurimit dhe/ose risigurimit, apo dega e shoqërisë së huaj të sigurimit, e licencuar nga Autoriteti;
- d) Shoqëria komisionere, apo dega e shoqërisë së huaj komisionere, e licencuar/regjistruar nga Autoriteti;
- e) Shoqëria administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, apo dega e shoqërisë së huaj administruese e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, e licencuar nga Autoriteti.

2. Të gjitha përkufizimet e tjera në këtë rregullore janë të njëjta me ato të ligjit nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat", referuar në këtë rregullore shkurt "ligji".

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë institucionet financiare, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 3 të kësaj rregulloreje që veprojnë si agjent i fondit të pensionit privat.
2. Agjenti i fondit të pensionit vepron në emër dhe për llogari të një shoqërie administruese të licencuar në Republikën e Shqipërisë.

Neni 5

Veprimtaritë e agjentit të fondit të pensionit

1. Agjenti i fondit të pensionit kryen veprimtarinë e promovimit të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese që administrojnë këtë fond, në emër dhe nën përgjegjësinë e plotë të shoqërisë administruese të fondit të pensionit.
2. Agjenti i fondit të pensionit ofron për anëtarët e mundshëm pjesëmarrjen në fondin e pensionit përmes nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese.
3. Agjenti i fondit të pensionit vepron si përfaqësues shitjeje i shoqërisë administruese gjatë promovimit të fondit dhe nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit në një fond pensioni.

Neni 6

Kriteret dhe kushtet për regjistrimin e agjentit

1. Agjenti i fondit të pensionit duhet të plotësojë kriteret dhe kushtet si më poshtë:
 - a) Të jetë institucion financiar;
 - b) Të ketë marrë paraprakisht miratim nga Autoriteti përkatës licencues, për të vepruar si agjent i fondit të pensionit;
 - c) Të ketë strukturën organizative të njësisë përgjegjëse për kryerjen e shërbimit të agjentit të fondit të pensionit;
 - d) Të ketë punonjës të aftë dhe të përshtatshëm për promovimin e fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese dhe nënshkrimin e kontratave me anëtarët e mundshëm;
 - e) Të ketë procedurë për njohjen e klientit dhe informacionin që duhet t'i jepet anëtarit të fondit gjatë promovimit të fondit të pensionit dhe para nënshkrimit të kontratës me anëtarin;
 - f) Të ketë procedurë për parandalimin dhe administrimin e konfliktit të interesit;
 - g) Të ketë procedurë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 - h) Të sigurojë shoqërinë administruese të fondit të pensionit për plotësimin e detyrimeve që lindin nga kontrata me palëve për shërbimin e agjentit të fondit.
2. Punonjësi i agjentit të fondit të pensionit privat duhet të plotësojë të paktën kushtet e mëposhtme:
 - a) Ka përfunduar të paktën studimet e shkollës së mesme;
 - b) Ka njohuritë dhe kuptimin e duhur mbi fondet e pensionit privat, të vërtetuara nga trajnime në këtë fushë;
 - c) Ka aftësi komunikimi me anëtarët e mundshëm të fondit dhe njohuri mbi procesin e shitjes;

- d) Nuk është në proces hetimor, gjyqësor, shpallur fajtor me vendim të formës së prerë për vepra penale kundër pasurisë ose në sferën ekonomike apo vepra të tjera penale lidhur me shoqëritë tregtare, për organizimin dhe vënien në funksionim të skemave mashtruese dhe piramidale, të huamarrjes, për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 7

Regjistrimi i agjentit nga shoqëria administruese

1. Shoqëria administruese regjistron në regjistrin e saj të agjentëve, agjentin e fondit të pensionit privat kur:
 - a) Vërteton nëpërmjet dokumentacionit përkatës plotësimin e kriterëve dhe kushteve sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje;
 - b) Ka nënshkruar kontratën e shërbimit të agjentit me agjentin e fondit të pensionit privat;
 - c) Sigurohet se procedurat vendosin kërkesa për transparencë dhe informacion të plotë për anëtarët e mundshëm të fondit të pensionit, për parandalimin dhe administrimin e konfliktit të interesit, për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
 - d) Sigurohet se agjenti ka hartuar programe trajnimi në vazhdimësi për punonjësit e vet.
2. Regjistri duhet të përmbajë minimalisht:
 - a) Emrin e shoqërisë;
 - b) Numrin e regjistrimit të shoqërisë në QKB; dhe
 - c) Adresën e zyrave qendrore.
 - d) Informacionin për punonjësit e agjentit:
 - i. Emrin dhe mbiemrin e personit;
 - ii. Adresën e përkohshme/e përhershme;
 - iii. Profesionin; dhe
 - iv. Marrëdhëniet mes personit dhe shoqërisë administruese.

Neni 8

Përgjegjësitë e agjentit të fondit të pensionit dhe e të punësuarve të tyre

1. Agjenti i fondit të pensionit, i regjistruar ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr. 76/2023, me aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti, dhe duhet:
 - a) Të veprojë me ndershmëri, korrektësi, drejtësi, profesionalizëm, pavarësi dhe vetëm në përputhje me interesin më të mirë të anëtarit të mundshëm, duke përdorur aftësitë dhe dijet e nevojshme, si dhe duhet të vlerësojë para nënshkrimit të kontratës së fondit të pensionit përshtatshmërinë e fondit të pensionit privat me kushtet dhe rrethanat e anëtarit të mundshëm;
 - b) Të mos japë informacione të gabuara ose informacione që mund të mashtrojnë anëtarin e mundshëm në lidhje me gjendjen e fondit, të paraqesë fakte të pavërteta dhe të pasakta në

lidhje me fondin, objektivat e investimeve, rreziqet e lidhura, çmimin e kuotës, kthimin nga investimi ose çdo çështje tjetër në lidhje me fondin ose shoqërinë administruese;

- c) Të përdorë vetëm prospektin, raportet mujore për ecurinë e fondit dhe materialet promovuese të miratuar nga një person kyç i shoqërisë administruese në emër të shoqërisë administruese të licencuar, gjatë promovimit të fondit të pensionit ose ofrimit të anëtarësimit në fond;
 - d) Të ruajë konfidencialitetin për të gjitha informacionet e marra nga anëtari i mundshëm;
 - e) Të informojë anëtarin e fondit për të gjitha tarifat që do t'i ngarkohen, opsionet e pagesës së pensionit me lindjen e së drejtës për pension, kushtet kur lind e drejtat e pensionit, kushtet për tërheqjen nga fondi apo transferimin e aktiveve, rreziqet e investimit, si dhe mënyra dhe afatet për informimin e anëtarit të fondit të pensionit, përpara nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit;
 - f) Të mbajë të dhëna të plota për çdo kontratë të nënshkruar dhe t'i përcjellë brenda ditës së punës kontratat e lidhura të anëtarësimit tek shoqëria administruese;
 - g) Të shmangë konfliktet e interesit, për të garantuar që interesat e anëtarëve të fondit të pensionit privat, për të cilin do të kryejë funksionin e agjentit, të kenë përparësi dhe të qëndrojnë mbi interesat e shoqërisë administruese dhe interesat e punonjësve të tij ose të çdo personi të lidhur me të në bazë të ligjit si dhe legjislacionit në fuqi, dhe aktet rregullative të miratuara nga Autoriteti në bazë të këtyre ligjeve. Agjenti i fondit të pensionit nuk duhet të nënshkruajë kontratën pa diskutuar më parë nëse ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit;
 - h) Të sigurojë parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - i) Të trajtojë, pajisë me manuale për procedurat e shitjes si dhe të testojë stafin e shitjes dhe të marketimit, minimalisht një herë në vit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;
 - j) Të zbatojë një procedurë në lidhje me trajtimin e ankesave të anëtarëve të fondit të pensionit privat.
2. Agjenti duhet të mbajë evidencat për të gjitha shërbimet, veprimtaritë dhe transaksionet që kryen, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi Autoritetit të përmbushë detyrat mbikëqyrëse, në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 76/2023.
 3. Agjenti nuk mund të delegojë përgjegjësitë e tij tek palë të treta.
 4. Agjenti duhet të ketë një regjistër të punonjësve/individë të autorizuar për të ushtruar veprimtarinë e agjentit të fondit të pensionit dhe do t'ia paraqesë atë Autoritetit me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 9

Përgjegjësitë e shoqërisë administruese të fondit të pensionit privat

1. Shoqëria administruese është përgjegjëse për saktësinë e informacionit të publikuar, me qëllim promovimin e fondeve të pensionit dhe veprimtarisë së shoqërisë administruese për fondet e

pensionit privat.

2. Shoqëria administruese e fondit të pensionit privat është përgjegjëse për veprimet dhe mosveprimet e agjentit në lidhje me anëtarin e mundshëm.
3. Shoqëria administruese monitoron veprimtarinë e agjentit të fondit të pensionit. Në rastet e dëmeve të shkaktuara anëtarit të fondit, shoqëria administruese duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin duke specifikuar edhe veprimet që duhet të ndërmerren për të ndaluar shkeljen dhe kur është e përshtatshme, të japë kompensim ose të rishikojë veprimet që janë ndërmarrë.
4. Shoqëria administruese mban regjistrin e agjentëve të fondeve të pensionit. Regjistri duhet të përmbajë emrin, selinë dhe të përshkruajë kompetencat e veçanta që duhet të ushtrojë në emër dhe për llogari të shoqërisë administruese agjenti i fondit të pensionit. Regjistri duhet të jetë i përditësuar dhe i vihet në dispozicion Autoritetit për qëllime referimi dhe inspektimi.
5. Shoqëria administruese e fondeve është përgjegjëse për sa më poshtë:
 - a) Në kontratën me agjentin të përcaktojë kushtet dhe afatin e kontratës, duke përfshirë natyrën dhe vlerën e çdo komisioni ose pagese që shoqëria administruese e fondeve i paguan agjentit;
 - b) Sigurohet që agjenti ka njohuritë dhe kuptimin e duhur të fondit të pensionit privat dhe e trajnon agjentin në mënyrë të vazhdueshme;
 - c) Sigurohet që agjenti të kuptojë plotësisht procesin dhe ka strukturën e duhur administrative për të siguruar raportimin në kohë ndaj shoqërisë administruese të fondeve;
 - d) Sigurohet që agjenti ka informuar anëtarin e fondit për të gjitha tarifat që do t'i ngarkohen, opsionet e pagesës së pensionit me lindjen e së drejtës për pension, kushtet kur lind e drejtae pensionit, kushtet për tërheqjen nga fondi apo transferimin e aktiveve, rreziqet e investimit, si dhe mënyra dhe afatet për informimin e anëtarit të fondit të pensionit;
 - e) Sigurohet që agjenti ka informuar anëtarin në lidhje me statusin e tij dhe shumën e komisionit që paguhet nga shoqëria administruese për angazhimin e tij në promovimin e fondit dhe ofrimin e kontratave të anëtarësimit në fondin e pensionit.

Neni 10

Informimi në lidhje me agjentët e fondit të pensionit

1. Shoqëria administruese mundëson në faqen e saj të internetit një listë të përditësuar të agjentëve të fondit të pensionit dhe duhet të garantojë që veprimtaria të kryhet vetëm përmes agjentëve të regjistruar.
2. Shoqëria administruese duhet të verifikojë rregullisht që agjentët e saj janë në përputhje të vazhdueshme me afatet dhe kushtet e licencës së shoqërisë administruese të fondeve dhe, nëse jo, duhet të ndërpresë të drejtën e agjentit për të ushtruar veprimtarinë dhe njofton menjëherë Autoritetin.

Neni 11
Informacioni që duhet dorëzuar pranë Autoritetit

1. Shoqëria administruese duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin brenda 5 ditëve pune, për çdo kontratë të lidhur me agjentët e fondit të pensionit.
2. Shoqëria administruese duhet të dorëzojë çdo muaj pranë Autoritetit një listë të përditësuar të agjentëve dhe punonjësve/individë të agjentit, me të cilët janë lidhur kontrata.
3. Lista e referuar në pikën 2 të këtij neni duhet të përfshijë informacionin sipas nenit 7, pika 2 e kësaj rregulloreje.
4. Shoqëria administruese i jep informacion Autoritetit mbi mënyrën e ruajtjes së të dhënave me qëllim që të mundësohet monitorimi dhe inspektimi i veprimtarisë së agjentit të fondit të pensionit.
5. Shoqëria administruese duhet të informojë me shkrim Autoritetin menjëherë pas ndërprerjes së kontratës me agjentin për heqjen e emrit të këtij agjenti të fondit të pensionit nga regjistri.

Neni 12
Monitorimi

1. Autoriteti monitoron aktivitetin e shoqërisë administruese në lidhje me kriteret e regjistrimit të agjentëve dhe ushtrimin e aktivitetit të tyre.
2. Në rastin kur Autoriteti, bindet se një agjent ka shkelur dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, informon për rezultatet shoqërinë administruese, e cila është përgjegjëse ndaj agjentit.

Neni 13
Dispozitë kalimtare

Të gjithë agjentët e fondeve të pensionit të regjistruar para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë regjistruar, me kusht që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje të përshtaten me kërkesat.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në menjëherë.